

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut,nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nebojša Boričić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palëve ankuese;**

O. dhe Xh. Q.a, nga K. Klinë, të paraqitur nga përfaqësuesi sipas autorizimit avokat Xh M nga Klina,

Kundër:

R. V. F., Srbobran, Srbija.

Palë përgjegjëse në ankesë,/Palë kërkuese në AKP/

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/140/2012, të datës 29 Shkurt 2012,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA...), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 08 Maj 2019, merr;

AKTGJYKIM

Hedhet Poshtë si e papranueshme ankesa e ushtruar nga i autorizuari i palëve ankuese O. dhe Xh.Q., avokat Xh. M. nga Klina, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPPC/D/A/140/2012, të datës 29 Shkurt 2012, për sa i përket kërkesës me numër, KPA...

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me datë 1 Janar 2007, R. V. F., (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronave (AKP), në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës së pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr., në sipërfaqe prej 3ha.65ar.40m2., me kulturë pyll e kl. IV, e cila gjendet në vendin e quajtur “Sabac”, Komuna Kadastrale Krnjice, Komuna Klinë në tekstin e mëtejme: (prona e kërkuar).
2. Në kërkesë thekson se është pronar i vetëm i pronës së kërkuar, e cila evidentohet në Fl. Poseduese n. 199, Komuna Kadastrale ...j, Komuna Klinë. Po ashtu deklaron se prona e kërkuar është e uzurpuar nga N.N. persona, andaj kërkon ri posedimin e saj.
3. Në mbështetje të kërkesës e tij, të njëjtës i bashkëngjit *inter alia* këto dokumente;
 - Fletën Poseduese nr. 199, të datës 17.03.1997, lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë Pejë -dega në Klinë, nga e cila vërtetohet se ngastra kadastrale, nr., në sipërfaqe

prej 3.65.40ha., me kulturë, mal i kl. IV., Komuna Kadastrale ...j, evidentohet në emër të F. (V.) R., me vendbanim në Srbobran, ...

- Letërnjoftimin e paraqitësit të kërkesës,(palës përgjegjëse në ankesë), me nr.pers...., të lëshuar nga Republika e Serbisë me datë 20.12.2001.
4. Me datë 03 Shtator 2007, AKP-ja bëri njoftimin dhe notifikimin e kërkesës, duke vendosur një afishë me informatat rreth kërkesës në pronën e kërkuar ,e cila në kohën e vizitës është gjetur se është mal, i pa shfrytëzuar apo uzurpuar nga askush.
 5. Me datë 31 Gusht 2010 Notifikimi dhe konfirmimi i kërkesës është bërë për mes publikimit në gazetën zyrtare nr.8, në UNHCR, njoftimi është publikuar edhe në Komunë Klinë Gjykatë Komunale në Klinë dhe tek udhëheqësi i fshatit Ramiz Dilaveri , në hyrje dhe dalje të fshatit Shtupel, dhe organet tjera relevante.
 6. Asnjë palë përgjegjëse nuk është paraqitur në Sekretarinë e AKP-së, për të kontestuar kërkesën e tani palës përgjegjëse në ankesë, para skadimit të afatit prej 30 ditë, ashtu si parashihet në kuptim të nenit 10.2., të Ligjit nr. 03/L-079, andaj kërkesa është konsideruar si e pa kontestuar nga askush.
 7. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të AKP-së, të datës 26 Tetor 2007, dokumentet e paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë, si dhe Fleta poseduese nr.199, e dt. 17.10.2007, është verifikuar me datë 17.10.2007, në departamentin e kadastrit në Klinë, dhe Letërnjoftimi në emër të tij, janë verifikuar pozitivisht.
 8. Me 29 Shkurt 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK), nëpërmjet Vendimit KPCC/D/A/140/2012, e pranoi kërkesën dhe konstatoi se, paraqitësi i kërkesës Radomir Filipović, ka dëshmuar se, është pronar me 1/1, të pronës së kërkuar dhe ka të drejtë në ri posedimin e pronës së kërkuar . Në arsyetimin e Vendimit të vet, (në paragraf nr. 11 dhe 12), që aplikohet në mënyrë specifike për kërkesën, KKPK-ja konkludoi se; aprovohet kërkesa e palës kërkuese sepse ka dëshmuar në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore se është pronar ligjor i pronës së kërkuar në bazë të dokumenteve pronësore të paraqitura nga pala kërkuese dhe të verifikuara si të vlefshme dhe relevante nga sekretaria.
 9. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë, me dt. 02 Korrik 2012.
 10. Me datë 01 Prill 2015, avokat Xh. M., i autorizuar nga palët ankuese O. dhe Xh. Qupeva (më tutje: pala ankuese), paraqiti ankesë kundër vendimit KPCC/D/A/140/2012, të dt.29.02.2012, në Kolegjin e Apelit të AKP-së, të Gjykatës Supreme.
 11. Palës përgjegjëse në ankesë R. F., (palë kërkuese në AKP), me datë 15. 02.2016, i është dorëzuar kopja e ankesës e palëve ankuese, për të paraqitur përgjigje në ankesën e tyre. I njëjti me datë 03 Mars 2016, ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese:

12. Pala ankuese, si palë e interesuar Vendimin e KKKPK-së, e atakon në tërësi që nënkuptohet nga të gjitha shkaqet ankimore, pasi që i është dhënë urdhër i dëbimit nga prona lëndore.
13. Në arsyetim të ankesës ndër të tjera thekson se, pretenduesi F. R. nuk është pronarë i pronës së kërkuar dhe as shfrytëzues i saj për kohën të cilën e cek se i është uzurpuar, sepse ai nga fillimi i viteve të 90-ta, nuk jeton në Kosovë por në Serbi në adresë të pa njohur për ta, se ky person me shpërnguljen nga Kosova pronën e kërkuar ja ka shitur fçiut të tij B.Dj. ,të cilën ai në vitin 1981 ja ka shitur babait të palëve ankuese të ndjerit K., se tani ankuesit janë në posedim të kësaj prone por bartjen e saj nuk kanë mundur ta bëjnë në emër të tyre apo prindit, për shkaqe objektive sepse ka ekzistuar ligji i cili e ka ndaluar shitblerjen e pronave, ndërsa pas lufte për shkak se nuk dihen adresat e shitësve në Serbi. Se me kuptimin e pretendimeve të palës kërkuese për këtë pronë në fillim të muajit mars 2015, ka parashtruar padi në gjykatë kompetente për dëshmimin e të drejtës pronësore, ndërsa për mes zyrës për minoritete është duke bërë përpjekje të kontaktoj palët shitëse për të bartur pronën në emër të tyre etj.
14. Në fund propozon që në këtë çështje të pezullohet procedura për dëbim nga prona deri në kontakt me shitësit, apo deri sa të përfundoj procedura kontestimore e filluar në Gjykatë në Klinë me nr. C.39/2015.(Ankesës i bashkëngjit, kopjen e padisë C nr.39/2015).
15. Pala përgjegjëse R. F., në përgjigjen e tij, ankesën e palëve ankuese paraqitur kundër vendimit të KKKPK-së e konteston si jo të lejueshme, andaj propozon që e njëjta të hedhet si e pa pranueshme, ose të refuzohet si e pa bazuar.
16. Në arsyetim pasi i citon nenet 12.1, mandej 10.1, 10.2, dhe 13.3 b), të Rreg. së UNMIK, nr.2006/50, ndër të tjera thekson se; pala ankuese nuk ka qen palë e paditur ,ndërsa i njëjti nuk është paraqitur në afatin prej 30 ditë pas pranimit të njoftimit nga AKP, mbi interesin e tij në këtë çështje, andaj nuk ka të drejtë në ankesë në vendimin e KKKPK, kërkon që ankesa të hedhet poshtë si e pa pranueshme, apo nëse nuk hedhet, e njëjta të refuzohet si e pa bazuar sepse ,nuk janë të vërteta theksimet se gjoja këtë pronë ja ka shitur B. Dj., në vitin 1981,sepse po ta kishte shitur në vitet 80-ta nuk ka qen në fuqi ligji që e kufizon shitblerjen andaj do të ja kishte bartur, se prona e kërkuar është e tij e cila është e uzurpuar, andaj kërkon që kjo ti kthehet në posedim.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

17. Kolegji i Gjykatës Supreme pasi shqyrtoi ankesën, Vendimin e ankimuar dhe shkresat e tjera të lëndës gjen se, Ankesa është e papranueshme në baza procedurale, pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën e zhvilluar në shkallën e parë në Komisionin për Kërkesa Pronësore Juridike të AKP-së.
18. Neni 12.1 i Ligjit nr.03/L-079, parasheh si në vijim: “*Pala mund të paraqet [...] ankesë kundër një vendimi të tillë brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për*

vendimin e KKKP-së mbi kërkesën". Po ashtu, neni 176.1 i Ligjit nr.03/L-079 për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) parasheh se (vetëm) palët mund të ushtrojnë ankesë kundër një aktgjykimi të shkallës së parë.

19. Neni 10.1 i Ligjit nr.03/L-079, parasheh se pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive njofton dhe dërgon një kopje të kërkesës çdo personi përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës.
20. Neni 10.2 i ligjit të njëjtë parasheh se *“Çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës dhe/ose ndonjë person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë ... , me kusht që ai person e informon Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij/saj që të merr pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive [...]”*.
21. Vetëm pala e cila ka marrë pjesë në procedurë në shkallën e parë, ka të drejtë që të paraqet ankesë kundër Vendimit të KKKP-së. Bazuar në praktikën e Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme, përjashtimi i vetëm ndaj këtij rregulli paraqitet nëse personi i cili mund të kërkojë një të drejtë mbi pronën e kontestuar, nuk ka pasur njohuri se kërkesa ishte paraqitur në AKP, apo për shkak të njoftimit të gabueshëm dhe prandaj ai/ajo nuk është në gjendje ta paraqet njoftimin dhe interesin e saj ligjor të pjesëmarrjes në procedurën e shkallës së parë në AKP.
22. Gjykata Supreme vlerëson se, pala ankuese nuk ka marrë pjesë dhe nuk e ka informuar AKP-në, rreth qëllimit të tij që të merr pjesë si palë në procedurën e shkallës së parë në AKP-së/KKKP-së, lidhur me lëndën KPA08462.
23. Nga shkresat e lëndës kuptohet se, shkalla e parë- Sekretaria e AKP-ja, përkatësisht ekipi i njoftimit dhe verifikimit, njoftimin e kërkesës e ka bërë si duhet në mënyrë të rregullt, ashtu si parashihet me dispozitat e lartë cekura ligjore,(shih shkresat e lëndës faqe 013-028). Ekipi kompetent i këtij organi me datë 03 Shtator 2007, bëri njoftimin dhe notifikimin e kërkesës, duke vendosur një afishe me informatat rreth kërkesës në pronën e kërkuar e cila në kohën e vizitës është gjetur se është mal, i pa shfrytëzuar apo uzurpuar nga askush. Po ashtu me datë 31 Gusht 2010, Notifikimi dhe konfirmimi është bërë për mes publikimit në gazetën zyrtare nr.8, në UNHCR, dhe po ashtu njoftimi për pronën e kërkuar (në të tri gjuhë), është publikuar në Komunë Klinë, Avokaturë publike, zyrën kadastrale, Gjykatë Komunale Klinë, mandej është lënë tek udhëheqësi i fshatit, është vendos në hyrje dhe dalje të fshatit Shtupel, dhe organet tjera relevante si OSCE, UNHCR, Obudsperson dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
24. Gjykata Supreme vëren se në bazë të fakteve të lartcekura, pala ankuese i ka pasur të gjitha mundësitë që të jetë në dijeni për procedurën që po zhvillohej në shkallën e parë, duke pasur parasysh se njoftimi ishte kryer si duhet duke i vendosur shenjat përkatëse te ngastra e cekur. Në ankesë nuk ka dhënë arsye pse nuk ka marrë pjesë në shkallën e parë e po ashtu nuk pretendon parregullsi lidhur me njoftimin e kërkesës për pronën kontestuese.

25. Nga gjendja e elaboruar si më lartë e duke i marrë para sysh theksimet në ankesë si dhe përmbajtjen e shkresave të lëndës, edhe pse ankesa është e pa pranueshme, megjithatë gjykata edhe pse nuk gjykoj për meritat e ankesës gjen se, Vendimi i KKPK-së, nuk është i përfshirë me gabime thelbësore apo me zbatim të gabuar të së drejtës materiale në fuqi, dhe nuk është i përfshirë me vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve mbi të cilat ka vendosur e të cilat i konteston pala ankuese, sepse pala ankuese në ankesë për veç se deklaron që e kanë blerë pronën e kontestuese, nuk ka paraqitur asnjë provë të besueshme apo të dokumentar, me të cilën do të vërtetohej ky transaksion dhe do të vihej në dyshim e drejta pronësore e palës përgjegjëse.
26. Nga faktet dhe konkludimet e cekura si më lartë, kolegji vlerëson se Ankesa duhet të hidhet poshtë si e pa pranueshme, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me nenin 12.1 dhe 13.3 (b), të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1, nën-paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
27. Ky aktgjykim nuk paragjykon të drejtën e palëve ankuese apo palëve të interesuara, për të kërkuar të drejtën e pretenduar para organit, apo gjykatës kompetente nëse e konsiderojnë me interes.

Këshillë ligjore;

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit UNMIK 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-014-2016, me datë 08 Maj 2019

Bashkp. Profesional
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Beshir Islami